

EKOMALT S4 normal/i shpejtë

Llaç rrafshues universal me modul të ulët elastik

Karakteristikat

EKOMALT S4 është një llaç sheshues i parapërzier dhe i përbërë nga lidhje çimentore, shtesa kimike dhe inerte siliciumi sipas kurbës së duhur të thermimit, i pajisur me fibra sintetike.

Fusha e përdorimit

Sheshim dhe rindërtim me trashësi të veçanta betoni dhe suva çimentoje të vjetra e të reja, por të qëndrueshme dhe të kapura mirë.

Avantazhe

- Tiksotropike dhe me tkurrje të kompensuar
- I aplikueshëm në trashësi nga 2mm në 4 cm
- Moduli i ulët elastik i jep mundësinë e aplikimit edhe mbi tulla, tjegulla e suva të vjetra çimentoje.
- Mundësi finiture me tre shtresa fine

Sipërfaqe të përshtatshme

Tulla-tjegulla në përgjithësi, beton, gurë të fortë, blloqe çimentoje, suva çimentoje

Përgatitje e sipërfaqeve

Sipërfaqet duhet të jenë të staxhionuara, të lara me kujdes, të pastruara nga pjesët që nuk kapen mirë, të paqëndrueshme apo në shkëputje dhe pa asnjë gjurmë bojërash të vjetra apo pjesësh të ngritura. Sipërfaqet duhen lagur më parë si dhe duhen trajtuar me FERMALT sidomos kur ka hekura të dalë.

Mënyra përdorimi

Përziej një thes 25 kg **EKOMALT S4** me rreth 4-5 l ujë të pastër me trapon përzierës derisa të përftohet një përzierje homogjene me plasticitetin e duhur. Lag sipërfaqet e caktuara dhe shtrije produktin duke përdorur brushë çeliku, trashësia nga 2 mm deri në 4 cm për kalim.

Me të përfunduar faza plastike me perdah sfungjeri jepi dorën e lustrës.

Në rast nevojë për shtresë të trashë këshillohet të laget produkti për 24-48 orët pas aplikimit

Të dhënat teknike dhe aplikative

	<i>Normal</i>	<i>I shpejtë</i>
* Pamja	Pluhur gri çimento	Pluhur gri çimento
* Pesha specifike e llaçit të freskët	rreth 1,920kg/m ³	rreth 2.100kg/lm ³
* Paketim	thes 25kg	
* Konsumi i mesëm për cm trashësi	rreth 17 kg pluhur/m ²	rreth 18kg pluhur/m ²
* Uji i përzierjes	18-20%	18-20%
* Qëndrueshmëria në përkulje (28 ditë)	3 Mpa	4 Mpa
* Qëndrueshmëria në shtypje (28 ditë)	15 Mpa	20 MPa
* Ngjitja për beton 28 ditë	1.2 N/m ²	
* Koha e zgjatjes së përzierjes (20° C)	rreth 40 min	rreth 10 min
* Diametri max inert	1 mm	
* Trashësia min	2 mm	
* Temperaturë përdorimi	+5°C / +35°C	
* Kohë ruajtjeje:	12 muaj nëse mbahet në vend të thatë e të freskët në ambalazhin origjinal të vulosur	

Paralajmërimë

- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira, në fazë shkrirjeje apo që mund të ngrihet në 24 orët e ardhshme
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe tepër të nxehta, ku ka shumë erë apo në pishë të diellit
- ** Mos e përdor mbi trashësi më të mëdha se 4 cm dhe mbi sipërfaqe të lyera apo të bojatisura
- ** Mos e përdor mbi mbajtëse të paqëndrueshme apo të lëkundshme nëse nuk janë konsoliduar më parë.
- ** Mos e përdor sipërfaqe të ngjyrosura aty-këtu ose ngjyra-ngjyra

Qëndrueshmëri mekanike:

Qëndrueshmëritë mekanike, të pasqyruara në tabelë, janë nxjerrë nga mostra 4 x 4 x 16 cm, të ambalazuara në laborator me 17.5% ujë dhe të maturuara në 20°C dhe U.R. 90%. Të dhënat mund të ndryshojnë ndërkohë që ndryshojnë kushtet e përzierjes e të staxhionimit.

Vërejt!

Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar dhe mund të modifikohen ndjeshëm nga kushtet e vënies në përdorim.